



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
SHOQATA AVOKATEVE PENALISTE  
TE SHQIPERISE. "SHAPSH"



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
INSTITUTI SHTEPIA E DREJTESISE  
DHE PAJTIMIT KOMBETAR  
"ISHDPK"

## Marrëveshje Bashkëpunimi

Ndërmjet

**Shoqatës së Avokatëve Penalistë**

**dhe**

**Institutit "Shtëpia e Drejtësisë dhe Pajtitimit Kombëtar"**

*Shoqata e Avokatëve Penalistë dhe Instituti « Shtëpia e Drejtësisë dhe e Pajtitimit Kombëtar »,  
bien dakord si më poshtë:*

### Neni 1

#### Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është përcaktimi i përgjegjësisë dhe detyrimeve të palëve nënshkruese të angazhuara në zbatimin e projekteve që kanë në fokus familjet me probleme sociale.

#### PERSHKRIM I SHKURTER I TEMES.

### Neni 2

#### Përfituesit

Përfituesit e projektit janë:

- a) Personat e prekur nga fenomene të ndryshme sociale të cilët kanë nevojë për asistencë ligjore dhe sociale për t'u riintegruar në shoqëri;

#### Neni 4

##### **Përgjegjësitë e palëve**

Palët nënshkruese kanë detyrimin e ndërsjelltë për t'i siguruar njëra tjetrës të gjithë informacionin e nevojshëm për zbatimin me sukses të kësaj marrëveshje.

##### **4A. Përgjegjësitë e përbashkëta do të jenë:**

1. Identifikimi i personave dhe familjeve që janë të prekur ose mbartin fenomene të mëdha sociale;
2. Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të asistencës ligjore, nëpërmjet trajnimeve profesionale në bashkëpunim me partnerët e identifikuar.

##### **4B. Përgjegjësitë e Shoqates së Avokateve Penaliste janë:**

- a) Të bashkëpunojë me ISHDPK në dhënien e asistencës ligjore për çdo person apo familje të identifikuar në nevojë;
- b) Të shkënbejnë informacione që kanë karakter informativ dhe që është në mbrojtje të personave të prekur nga fenomeni i gjakmarrjes;
- c) Të shkënbejnë informacione me ISHDPK për çdo denoncim apo kërcënim apo konfliktet që mund të sjellë pasoja të rënda për jetën e qytetarëve.
- d) Të ndajë informacionin me ISHDPK mbi projektet me qëllim mbrojtjen e grupeve targetuese në kuadër të Politikave apo strategjike që vijnë në ndihmë të familjeve apo personave të prekur nga ky fenomen;
- e) Të konsultohet me ISHDPK paraprakisht për njoftimet publike që kanë në fokus personat e prekur nga fenomeni i gjakmarrjes;

##### **4C. Përgjegjësitë e ISHDPK do të jenë:**

- a) Identifikimi i personave dhe familjeve që janë të prekur nga fenomeni i gjakmarrjes;
- b) Dhënia e kontributit maksimal në zgjidhjen e konflikteve sociale, të pajtimit në familjet që janë të përfshira në konflikte sociale;
- c) Mbështetja me asistencë sociale, ekonomike dhe ligjore të fëmijëve dhe grave si grup vulnerabël si edhe personat e kësaj shtrese që janë të prekur nga fenomeni i gjakmarrjes;

- d) Identifikimi i shkeljeve të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e viktimave që sjell ky fenomen;
- e) Rritje e ndërgjegjësimit të popullatës në iniciativat kundër çdo fenomeni që agravon situata sociale
- f) Rritje e ndërgjegjësimit të insitutioneve të tjera qeveritare si dhe ato jo qeveritare, kombëtare dhe ndërkombetare për zhvillimin e politikave sociale;
- g) Sigurimi i mbështetjes psikologjike, sociale, juridike, arsimore dhe ekonomike për familjet në nevoje si edhe personat ose grupet e prekura nga fenomeni i gjakmarrjes sa herë qe realizohen ngritje fondesh;
- h) Publikimi i materialeve ndihmëse dhe promocionale për familjet në nevoja sociale në bashkepunim edhe me institutionet e tjera mbështetëse ;
- i) Monitorimi i vazhdueshëm i përsoneve të familjeve të prekura nga fenomene të rënda sociale;

#### Neni 5

#### Mosmarrëveshjet

Në raste mosmarrëveshjes, palët do të përpiqen që zgjidhja e tyre të bëhet me mirëkuptim.

#### Hyrja në fuqi

- a) Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi me nënshkrimin e saj nga përfaqësuesit e autorizuar të palëve nënshkruese;
- b) Kjo Marrëveshje mund të mbyllet nga secila prej palëve nënshkruese me një njoftim me shkrim para ndërmarrjes së këtij akti e cila duhet të jetë e bazuar ne argumente;
- c) Kjo Marrëveshje mund të modifikohet me shkrim në çdo kohë me pëlqimin e të dyja palëve nënshkruese;

Finalizuar në Tiranë më 11.02, 2014, në dy kopje origjinale në shqip.

*Agim Loci*

Z. Agim Loci  
Drejtor Ekzekutiv  
Për Insitutin "Shtëpia e Drejtësisë dhe e Pajtimit Kombëtar"



*Sajmir Vishaj*

Z. Sajmir Vishaj  
Kryetar  
Shoqata e Avokateve Penalist  
e Shqiperise





## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

**Për institucionalizimin e marrëdhënieve ndërmjet institucionit të Avokatit të Popullit dhe Institutit “Shtëpia e Drejtësisë dhe e Pajtitit Kombëtar”.**

Me qëllim që të realizojnë një veprimtari të përbashkët në respektimin, garantimin, forcimin dhe avancimin e mbrojtjes dhe marrjes seriozisht të çështjes “gjakmarrje” në Shqipëri; që të rrisin bashkëpunimin në drejtim të forcimit të zbatimit të legjislacionit, politikave të reja në fushën e rritjes së cilësinë e shërbimeve, për të ndaluar e parandaluar rastet e veprimtarisë arbitrare nga organet e administratës publike, si dhe për të kërkuar ndërhyrjen pozitive të shtetit sa herë që paraqitet nevoja për ndalimin e dhunës, diskriminimit apo paragjyqimit, lidhet kjo marrëveshje, si vijon:

**Palët,**

- 1. Avokati i Popullit, Z. Iglí Totozani,** me seli në Blv. “Zhan D’Ark”, Nr.2, Tiranë.  
dhe
- 2. Z.Agim Loci Drejtorit Ekzekutiv i Institutit “Shtëpia e Drejtësisë dhe e Pajtitit Kombëtar”,** me seli në Blv Zogu I-rë Qendra Tregtare “TIRANA”,Tiranë.

### **Neni 1**

#### **Objekti i Marrëveshjes**

Kjo marrëveshje ka për qëllim, institucionalizimin e bashkëpunimit të institucionit të Avokatit të Popullit me Institutin Shtëpia e drejtësisë dhe e pajtitit kombëtar, në kuadrin e punës së përbashkët dhe garantimit të realizimit të misioneve të përbashkëta vëzhguese në fokus fëmijët e familjet e ngujuara, zhvillimit të politikave dhe ligjeve në favor të këtij komuniteti luftës për eliminimin e diskriminimit për shkak të moshës, statusit, gjinisë, fesë, si dhe për avancimin e të drejtave të personave të ngjuar në Shqipëri, përfshirë ndër të tjera edhe avancimin e barazisë gjinore dhe pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje, të minoriteteve dhe të të drejtave të njeriut në përgjithësi.

## **Neni 2**

### **Fusha e zbatimit**

1.Marrëveshja do të zbatohet midis palëve të lartpërmendura, në fushën e kësaj marrëveshje për të përmbushur objektin e saj.

2.Kjo marrëveshje do të konsistojë në:

- a) Ndërmarrjen e nismave të përbashkëta për propozime në kuadër të përmirësimit dhe ndryshimit të legjislacionit me fokus personat e ngjuar apo të prekur nga fenomeni i gjakmarrjes në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventat e ratifikuara nga shteti Shqiptar në fushën e mbrojtjes së drejtave të njeriut.
- b) Referimin e rasteve konkrete, sipas nevojave të ankuesit/es, përfshirë edhe referimin e rasteve të ndërsjelltë midis Institutit "Shtëpia e drejtësisë dhe e pajtimit Kombëtar dhe institucionit të Avokatit të Popullit.
- c) Marrjen e iniciativave të përbashkëta për adresimin, referimin dhe zgjidhjen e rasteve konkrete, pranë organeve kompetente e gjykatave kombëtare, gjykatës Kushtetuese, si dhe organeve përkatëse ndërkombëtare.
- d) Angazhimin e organizatës për të informuar Avokatin e Popullit për çështjet dhe problematikat, si dhe përgjithësimet e dala nga raportet monitoruese, në lidhje me çështjet e fenomenit të gjakmarrjes.
- e) Shkëmbimin e rregullt të informacionit nëpërmjet organizimit të takimeve periodike, shkëmbimit të informacionit, vizitave të përbashkëta në terren, njoftimeve reciproke për raste të ndryshme që kanë nevojë për ndërhyrje dhe mbështetje.
- f) Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta ndërgjegjësuere në nivel kombëtar, përfshirë edhe organizimin e fushatave të përbashkëta për ndërgjegjësimin e publikut.

## **Neni 3**

### **Koordinimi ndërmjet palëve**

1.Palët do të caktojnë një person kontakti, që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret dhe në rrugë operacionale të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, si dhe për shkëmbimin e informacionit lidhur me të.

2.Komunikimi ndërmjet palëve do të jetë në formë shkresore. Për rastet kur palët kërkojnë një informacion të rëndësishëm dhe urgjent për t'u përcjellë, komunikimi mund të bëhet dhe në mënyrë elektronike dhe verbale, por në çdo rast përmes personave të kontaktit.

## **Neni 4**

### **Dispozitat e fundit**

1.Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar.

2.Ndryshimet mund të bëhen me marrëveshje nga Palët nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim duke saktësuar datën e hyrjes në fuqi.

3.Çdo mosmarrëveshje krijuar mbi interpretimin ose ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.

4. Përveç parashikimit të paragrafit 1 të këtij neni, kjo Marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë, duke njoftuar paraprakisht 60 ditë para me shkrim, palën tjetër.

5.Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe, përgatitet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale, njëra për ISHDPK dhe tjera për Avokatin e Popullit.

Avokati i Popullit

Igli TOTOZANI



ISHDPK

Agim LOCI  
Drejtor Ekzekutiv



## Memorandum Bashkepunimi

Ndërmjet

Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve (DHKN)

Dhe

Instituti "Shtëpia e Drejtësisë dhe Pajtimit Kombëtar" (ISHDPK)

**Për bashkepunim në lidhje me çështjet në pajtimin dhe ndërmjetësim të mosverveshjes në Republikën e Shqipërisë**

### I. Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi është të përcaktojë parimet dhe objektivat në lidhje me përpjekjen e përbashkët për të promovuar dhe zhvilluar më tej problemet e pajtimin të familjeve që kanë problem me fenomenin e Gjakmarrjes dhe ndërmjetësimin, si metodë alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Bazuar në këto parime, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve (DHKN) në bashkëpunim me Institutin "Shtëpia e Drejtësisë dhe Pajtimit Kombëtar" synon të mbështesë punën për të realizuar këto qëllime.

Objektivi i këtij bashkëpunimi është të ndihmojë këtë Institut në këto fushte të rëndësishme. DHKN do të mbështesë për hartim dhe zbatim të projekteve të ndryshme.

### II. Historik

Krijimi i sistemit të ndërmjetësimin në Shqipëri pajtohet me kuadrin ekzistues ligjor dhe gëzon mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë dhe JUST

DHKN-ja është një Ent Publik që e ushtron veprimtarinë në mënyrë të pavarur. Ajo është themeluar më datë 7 korrik 2013, në pajtim me ligjin nr. 10 385, "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve". Ajo merr masa për të rregulluar dhe kontrolluar veprimtarinë e ndërmjetësimin në Republikën e Shqipërisë. Për të zhvilluar aktivitetin e saj, por edhe në drejtim të rritjes së cilësisë dhe efektshmërisë së procesit të ndërmjetësimin, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me organizata jopërfutuese, apo me organe të tjera të sistemit të drejtësisë.



## **Memorandum Bashkepunimi**

Ndërmjet

**Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve (DHKN)**

Dhe

**Instituti “Shtepia e Drejtësisë dhe Pajtimit Kombëtar” (ISHDPK)**

**Për bashkepunim në lidhje me çështjet në pajtimin dhe ndërmjetësim të mosverveshjes në Republikën e Shqipërisë**

### **I. Qëllimi**

Qëllimi i këtij Memorandumi është të përcaktojë parimet dhe objektivat në lidhje me përpjekjen e përbashkët për të promovuar dhe zhvilluar më tej problemet e pajtimit të familjeve që kanë problem me fenomenin e Gjakmarrjes dhe ndërmjetësimin, si metodë alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Bazuar në këto parime, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve (DHKN) në bashkëpunim me Institutin “Shtepia e Drejtësisë dhe Pajtimit Kombëtar” synon të mbështesë punën për të realizuar këto qëllime.

Objektivi i këtij bashkëpunimi është të ndihmojë këtë Institut në këto fusha të rëndësishme. DHKN do të mbështesë për hartim dhe zbatim të projekteve të ndryshme.

### **II. Historik**

Krijimi i sistemit të ndërmjetësimin në Shqipëri pajtohet me kuadrin ekzistues ligjor dhe gëzon mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë dhe JUST

DHKN-ja është një Ent Publik që e ushtron veprimtarinë në mënyrë të pavarur. Ajo është themeluar më datë 7 korrik 2013, në pajtim me ligjin nr. 10 385, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”. Ajo merr masa për të rregulluar dhe kontrolluar veprimtarinë e ndërmjetësimin në Republikën e Shqipërisë. Për të zhvilluar aktivitetin e saj, por edhe në drejtim të rritjes së cilësisë dhe efektshmërisë së procesit të ndërmjetësimin, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me organizata jopërfituese, apo me organe të tjera të sistemit të drejtësisë.



Instituti "Shtepia e Drejtësisë dhe Pajtimit Kombëtar" është një OJF është krijuar me Vendim nr 575 date 29 dhjetor Gjykatës Rrethit Tiranë . Ka një aktivitet të rëndësishëm dhe të suksesshem në fushën e : parandalimit e urrejtjes dhe vrasjes për gjakmarrje në Shqipëri, mbrojtjen e jetës për familje të kërcënuara mes tyre, identifikimin e të gjithë popullsisë të prekur nga ky fenomen, zgjidhjen e konflikteve dhe pajtimin e gjakeve në familjet e prekura shqiptare, mbrojtjen e individëve dhe grupeve sociale , mbrojtjen e femijëve dhe grave të prekura nga ky fenomen dhe mbështetja e emigrantëve neper bote në bashkëpunim me DHKN , problemet e ndryshme të mosmarrëveshjeve.

### III. Baza ligjore

Baza ligjore ekzistuese që lejon shfrytëzimin e ndërmjetësimit si një alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në çështjet tregtare dhe familjare, përfshin si më poshtë:

- Ligjin nr. 8116, datë 29 mars 1996, "Për kodin e procedurës civile në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 10 385, datë 24 shkurt 2011, "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve";
- Ligjin nr. 9223, datë 3 maj 2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- Ligjin nr. 8788, datë 7.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", të ndryshuar nr. 9901, datë 14 prill 2008,

### IV. Përkufizime

Pajtimi dhe ndërmjetësimi është një veprimtari jashtë gjykatës, përmes së cilës palët kërkojnë të zgjidhin një mosmarrëveshje me ndihmën e një personi të tretë asnjans (ndërmjetësi), në mënyrë që të gjejnë një zgjidhje të pranueshme për palët, e cila nuk bie ndesh me ligjin.

### V. Përgjegjësitë e përgjithshme të palëve

#### Instituti "Shtepia e Drejtësisë dhe Pajtimit Kombëtar"

- Punojë ngushtë me DHKN-në për të lehtësuar zbatimin e programit të Projekteve dhe Donatorët
- Sigurohet raste të ndryshme dhe për vijim të Misionit të tij dhe DHKN sipas kuadrit ligjor për ndërmjetësimin dhe pajtim në Shqipëri .
- Sigurojë hapësirë të përshtatshme për realizimin e shërbimit të pajtimin dhe ndërmjetësimit .
- Marrë hapa dhe jep raste për t'u siguruar se janë referuar për ndërmjetësim çështjet e duhura DHKN.
- Shërbejë si burim rastesh për median në bashkëpunim me znj Eni Cobani, Kordinatore e Medias,

#### DHKN-ja do të:

- Vazhdojë të menaxhojë dhe zbatojë modelin e pajtimin dhe ndërmjetësimit pa shkuar në Gjykatë për çështjet civile, familjare dhe tregtare, në koordinim me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare.

- Vazhdojë të përdorë dhe përmirësojë procedurat dhe praktikat për menaxhimin e çështjeve, të përgatitura nga ISHDPK, për të siguruar një zbatim të suksesshëm në bashkëpunim me DHKN.
- Angazhohet për të ndërgjegjësuar më tej publikun përsa i përket avantazheve që sjell ndërmjetësimi;
- Angazhohet për të mbështetur trajnimin e ndërmjetësve dhe të menaxhojë, të përpilojë projektet me donatore kombëtare dhe ndërkombëtare për ISHDPK.

Palët duhet të shkëmbejnë me njëra-tjetrën informacionin që mund të nevojitet për të mundësuar sigurimin e asistencës, sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi, dhe për të vlerësuar efektshmërinë e kësaj asistence. Gjithashtu, palët do të takohen periodikisht për ta shqyrtuar këtë asistencë, dhe në rast pamundësie për të marrë pjesë në këto takime, do të shkëmbejnë informacionin përkatës.

#### **A. Modifikimi dhe ndërprerja**

Ky memorandum mund të pësojë ndryshime, modifikime ose të ndërpritet në formë të shkruar nga ana e palëve. Secila nga palët mund t'i japë fund pjesëmarrjes në këtë memorandum, duke i dhënë palës tjetër një njoftim me shkrim 30 (tridhjetë) ditë përpara këtij përfundimi.

Ndërprerja e angazhimit në këtë memorandum i jep fund të gjitha përgjegjësisve të palëve.

#### **B. Hyrja në fuqi dhe afati**

Ky memorandum do të hyjë në fuqi duke filluar nga data e nënshkrimit nga palët dhe do të qëndrojë në fuqi deri në momentin kur ai do të ndërpritet nga palët.

#### **C. Përfaqësuesit**

Palët do të përfaqësohen nga vetë titullarët. Secila nga palët, përmes një njoftimi me shkrim për palën tjetër, mund të caktojë përfaqësues shtesë që do të jenë të autorizuar ta përfaqësojnë atë palë për të gjitha synimet e saj, përveç ekzekutimit të ndryshimeve formale në këtë Memorandum Mirëkuptimi. Secila palë duhet të njoftojë me shkrim për çdo ndryshim të përfaqësuesve të autorizuar.

**NË DËSHMI TË KËTIJ DOKUMENTI**, palët, përmes përfaqësuesve të tyre të autorizuar sipas rregullave, bien dakord të firmosin këtë Memorandum Mirëkuptimi në datën e përcaktuar më poshtë.

Tiranë, më 17 Janar 2014, në dy kopje origjinale

  
**Drita Avdyli**  
 Kryetare  
 Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve



  
**Agim LOCI**  
 Drejtor Ekzekutiv  
 Instituti Shtetia e Drejtësisë dhe Pajtimit Kombëtar

